



CRNA GORA – MALI I ZI
Opština Tuzi – Komuna e Tuzit
Sekretarijat za poljoprivredu i ruralni razvoj
Sekretariati për bujqësi dhe zhvillim rural
Br.Nr: 06-032/22- **6758**
Tuzi- Tuz **U. 06** 2022. godine

Adresa: Tuzi bb
81206 Tuzi, Crna Gora
Tel: 020/875-167
www.tuzi.org.me

Bazuar në vendimin për nxitje dhe investime në zhvillimin e bujqësisë të Komunës së Tuzit (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, nr. 046/21, datë 30.12.2021) si dhe në Programin e masave për realizimin e mjeteve për zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Tuzit për vitin 2022, - Agrobuxheti (“Fleta Zyrtare e Malit të Zi – Dispozitat Komunale”, Nr. 015/22, datë 08.04.2022), Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural shpallë

THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTETJEN E KORRJES SË DRITHËRAVE TË IMTA PËR VITIN 2022

I

Përfitues të fondeve mbështetëse sipas kësaj Ftese Publike janë prodhuesit bujqësorë, të cilët janë të regjistruar në regjistrin e njësive bujqësore të mbajtur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave.

II

Mbështetja në këtë Thirrje Publike i referohet financimit të një pjese të shpenzimeve të korrjes së drithërave të imta për njësi të sipërfaqes së shprehur në hektar si njësi matëse.

III

Shuma e mbështetjes për korrjen e drithërave të imta do të jetë maksimumi 75 €/ha. Nëse shuma totale e të gjitha kërkesave për mbështetje sipas kësaj thirrjeje publike tejkalon mjetet e planifikuara buxhetore, pagesat për njësi reduktohen proporcionalisht me shumën e mjeteve të planifikuara.

Për realizimin e kësaj mase të paraparë me komponentin buxhetor të Subvencionimit për Mbështetjen e Prodhuesve Bujqësor, që ka të bëjë me Mbështetjen e Korrjes së Drithërave, është paraparë shuma prej 9,000,00 €.

IV

Dokumentacioni i kërkuar për dhënien e kësaj mbështetje: Kërkesa e plotësuar për dhënien e mbështetjes për korrjen e drithit për vitin 2022 - ANEKSI I (i cili është pjesë përbërëse e kësaj Thirrje Publike; Certifikata si dëshmi e sipërfaqes së korrur e lëshuar nga korrësi dhe fotokopja e letërnjoftimit.

V

Formulari i Aplikimit për Mbështetjen e korrjes së drithërave të imta për vitin 2022 (ANEKSI I) mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Komunës së Tuzit (www.tuzi.org.me) dhe në zyrën e Sekretariatit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Formulari i plotësuar i aplikimit për dhënien e mbështetjes për korrjen e drithërave në vitin 2022, me dokumentacion shoqërues do të dorëzohet në arkivin e Komunës së Tuzit. Informacionet lidhur me këtë thirrje publike mund të merren në numrin e telefonit: 020/875 167; 067/179 - 284 dhe 067/083 - 367.

Kohëzgjatja e Thirrjes Publike është nga data 21 qershor 2022 deri më 30 korrik 2022.

Përpunimi i kërkesave të pranuar do të bëhet gjatë thirrjes publike, ndërsa pagesa do të bëhet pas përfundimit të thirrjes publike.

VI

Aplikanti është përgjegjës për saktësinë e të dhënave dhe dokumentacionit për ushtrimin e të drejtës për mbështetje.

Komuna e Tuzit, Sekretariati për Bujqësi dhe Zhvillim Rural rezervon të drejtën që para pagesës të kontrollojë realitetin dhe vlefshmërinë e vlerave të paraqitura, si dhe të iniciojë verifikimin financiar të të gjitha faturave të pranuar pranë organeve kompetente;

Nëse në procesin e verifikimit financiar të realitetit dhe vlefshmërisë së shpenzimeve të paraqitura pranë autoriteteve kompetente, konstatohet se përfituesi në çfarëdo mënyre ka mashtruar ose fshehur fakte personit përgjegjës për dhënien e mbështetjes, ai është i detyruar të kthejë fondet mbështetëse që janë të shpenzuara në mënyrë të papërshtatshme, të shtuara me shumën e interesit të vonesës;

Mbështetja mund të merret vetëm me dëshminë e bashkangjitur se të korrat janë paguar;

Dokumentacioni i dorëzuar jo i plotë dhe i parakohshëm nuk do të merret parasysh.